



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:110639

Datë: 18.07.2024

Numri i dokumentit: 05951421

KF.nr.491/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në kontestin tregtar administrativ të paditësit Universum Commerce te Luzha, sh.p.k, me seli në Ferizaj, të cilin e përfaqëson Kemajl Luzha pronari personalisht, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlera e kontestit 3,783.95 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të paditësit Kemajl Luzha, dhe përfaqësueses së palës së paditur Blerta Gagica, me datë 04.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Universum Commerce te Luzha, sh.p.k, me seli në Prishtinë.
- II. ANULOHET aktvendimi me nr.05.2.1/575; 768/2011 i datës 29.04.2021 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit Universum Commerce te Luzha, sh.p.k, me seli në Prishtinë, t'ia kthej shumën prej 3,783.95 € (tre/mijë/e/shtatëqind/e/tetëdhjetë/e/tre/euro/e/nëntëmbëdhjetë/e/pesë/ cent), të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-21688/11.05.2011 R-23232/18.05.2011, R-23339/19.05.2011, R-27108/07.06.2011 dhe R-33136/07.07.2011, të proceduar në ZBD Hani i Elezit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.
- IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.05.2.1/575; 768/2011 i datës 29.04.2021. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka deklaruar se: besoj se të gjitha këto argumente tregojnë se Dogana nuk ka vepruar drejte në rritjen e çmimit andaj në kërkojmë të aprohet padia si e bazuar, të anulohet vendimi kontestues dhe të obligohet e paditura që këtu paditësit të ia kthejë mjetet e paguara me tepër si rezultat i rivlerësimit të mallit me DUD-at kontestues dhe atë: për takse doganore shumen prej 1.689.83 €, për TVSH shumen prej 2.094.12 € e të gjitha këto se bashku në shume prej 3.783.95 €, shume kjo e paguar përmes pagesës bankare të datës 21.04.2022 dhe e theksuar si etile edhe në faqen 2 të aktvendimit kontestues. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë, e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se aktvendimi është marrë konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, ngase vendimi i kontestuar është marrë komform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme relevante juridike. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit ka deklaruar se: Mbesim në tersi pranë përgjigjes në padi dhe deklarimeve në seancat e kaluara. Ekspertiza është e pa qarte në fq 9, ku janë të theksuara pagesat por të njëjta nuk i ka harmonizuar me faturat. Po ashtu në faqen 10 eksperti thekson se transferet janë dëshmuar nga paditësi me dëftese pagesat e nxjerrë nga sistemi i E-banking bankës TEB, mirëpo këto pagesa janë pagesa që janë bërë Doganës si dhe pjesa kur thekson në varësi të marrëveshjeve afariste që kanë shitësi dhe blerësi paguhet një pjesë e mallit në fillim të porosis pastaj sipas marrëveshjes paguhet edhe pjesa tjetër, mirëpo duke pasur parasysh se paditësi nuk ka prezantuar kontratë këtu eksperti nuk e di se ku i është referuar marrëveshjeve, i njëjti ka pasur për detyrë që të harmonizojë edhe dokumentet e tjera përcjellëse lidhur me këtë çështje. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 04.07.2024, ka administruar provat dhe atë: aktvendimi 05.2.1/575,768/2011 i datës 29.04.2021, DUD-at 41655, 21688,23232, 23339, 27108, 33136,

20969, 24978, 34401, 36486, 37143, faturat e DUD a-ve kontestues, CMR, EUR 1, DV 1, proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, pagesat bankare ndërkombëtare të datës 29.04.2011, 04.05.2011, 10.05.2011, 17.05.2011, 17.05.2011, 27.05.2011, 06.06.2011, 21.06.2011, 07.07.2011, 12.07.2011, 14.07.2011, 25.07.2011, 28.07.2011, 11.08.2011, 12.08.2011, 16.08.2011, 29.11.2011, 08.09.2011, përgjigja në padi, aktvendimi 05.2.1/575, 768 e datës 10.08.2011, aktvendimi 07.4/389, 492, 575, 768 i datës 04.04.2014, aktvendimi A.nr.287-DK-2011 i datës 07.02.2014, aktvendimi 05.2.1/313-329, 371 dhe 376 i datës 29.06.2012, ankesa e ushtruar në BPR, ekspertiza financiare e datës 03.06.2024, pagesa bankare e detyrimeve doganore e datës 21.04.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjen në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, deklarimeve në ankesë, shkresave të lëndës, aktvendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestues fakti se subjekti në procedurë këtu paditësi Universum Commerce të Luzha, sh.p.k, me seli në Ferizaj, përmes DUD-ave R-21688/11.05.2011 R-23232/18.05.2011, R-23339/19.05.2011, R-27108/07.06.2011 dhe R-33136/07.07.2011, të proceduar në ZBD Hani i Elezit, ka deklaruar për zhdoganim mallin lëndor sipas dokumentacionit përcjellës të mallit. Nuk është kontestues as fakti tjetër se e paditura e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit nga këtu paditësi, e ku si rezultat i kësaj përmes Procesit mbi Përcaktimin e Vlerës së Mallrave, ka caktuar bazë të re doganore për këtë mall, duke u bazuar në metodën e (6) gjashtë të vlerësimit nga neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës Nr.03/L-109. Po ashtu, nuk është kontestues as fakti se paditësi ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës, e për të cilën ankesë e paditura me datë 29.04.2021 ka sjell aktvendimin nr.05.2.1/575; 768/2011, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, e kundër të cilit aktvendim paditësi me padinë e datës 04.06.2021, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë, këtu paditësit për rishqyrtimin e Deklaratave Unike Doganore R-21688/11.05.2011 R-23232/18.05.2011, R-23339/19.05.2011, R-27108/07.06.2011 dhe R-33136/07.07.2011. Me arsyetim se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur e ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit të kësaj gjykate ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin financiar Sh.S. e i cili ka pasur për detyra sikurse ne aktvendimin përkatës.

Eksperti financiar në ekspertizën financiare të datës 03.06.2024, ka mendimin dhe konstatimin e tij për detyrat e dhëna me aktvendimin e kësaj gjykate, ndërsa në seancën e datës 04.07.2024, deklaron dhe sqaron se : *mbes ne tërësi pranë ekspertizës financiare te punuar ne këtë lende, sa i përket DUD-ave kontestues dallimi ne vlere i detyrimeve për shkak te ri vlerësimit është dashur te jete 3.283.95 € , mirëpo e paditura pasi qe e ka nxjerrë vendimin kontestues te datës 29.04.2021, ne faqen 2 ka kalkuluar vlerë tjetër ne shume prej 3.783.95 €, vlerë kjo e paguar nga paditësi me pagesën bankare te datës 21.04.2022 dhe tanimë kjo vlere mbetet si vlerë e kontestit , respektivisht si vlere e paguar për shkak te rivlerësimit te mallit nga e paditura. Lidhur me këtë kam dhëne sqarime ne faqen 10 pika 3 te ekspertizës.*

Gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe ia dha besimin e plotë ekspertizës financiare dhe sqarimeve të dhëna në seancë, ngase ekspertiza i përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, dhe ka arsyetime të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoj si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë kontest tregtar administrativ, si dhe e njëjta është në harmoni me legjislacionin doganor të aplikueshëm.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-

ave R-21688/11.05.2011 R-23232/18.05.2011, R-23339/19.05.2011, R-27108/07.06.2011 dhe R-33136/07.07.2011, të proceduar në ZBD Prishtinë, dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 3,783.95 €, mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi nuk është vlere reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së.

Gjykata konsideron se paditura do të mund ta mbështetet një konstatim të tillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues i ka paguar eksportuesit mbi çmimin neto të faturave të mallit, ku vlere e mallit të faturuar nga eksportuesi është paguar nga paditësi përmes Urdhërpagesave Bankare Ndërkombëtare të datës 29.04.2011, 04.05.2011, 10.05.2011, 17.05.2011, 17.05.2011, 27.05.2011, 06.06.2011, 21.06.2011, 07.07.2011, 12.07.2011, 14.07.2011, 25.07.2011, 28.07.2011, 11.08.2011, 12.08.2011, 16.08.2011, 29.11.2011, 08.09.2011, e të cilat në kuptim të përshkrimit të pagesës dhe vlerës është janë të harmonizuara me faturat e DUD-ve kontestues si më lartë.

Gjykata vlerëson se nuk përbën shkak ligjor për rivlerësim të mallit dhe caktim të bazës së re doganore për paditësin, fakti që e paditura disponon me të dhëna nga Dosja e vlerës, në bazë të të cilit vlere e mallit është dukshëm më e lartë se vlere e deklaruar nga subjekti, sepse me dispozitën ligjore të nenit 31 par.1 të KDAK-së nuk thuhet që vlere doganore e mallrave të importuar duhet të jetë e njëjtë me vlerën e mallrave të marra nga Dosja e Vlerës, por aty përkundrazi shprehimisht përcaktohet se *“Vlere doganore e mallrave të importuara është vlere e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”*.

Sipas nenit 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, është parashikuar që, dokumenti që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit është: *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Në interpretim të drejtë të dispozitave ligjore të cituara, Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka paraqitur faturat për DUD-at kontestues R-21688/11.05.2011 R-23232/18.05.2011, R-23339/19.05.2011, R-27108/07.06.2011 dhe R-33136/07.07.2011, të paguar me Urdhërpagesave bankare ndërkombëtare të datës 29.04.2011, 04.05.2011, 10.05.2011, 17.05.2011, 17.05.2011, 27.05.2011, 06.06.2011, 21.06.2011, 07.07.2011, 12.07.2011, 14.07.2011, 25.07.2011, 28.07.2011, 11.08.2011, 12.08.2011, 16.08.2011, 29.11.2011, 08.09.2011, e të cilat pagesa siç u theksua më lartë janë të harmonizuara. Pra, në këto rrethana Gjykata vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Gjykata konstaton se shuma e paguar më tepër nga paditësi prej 3,783.95€, në emër të detyrimeve doganore, si pasoj e ri-vlerësimit të mallit nga e paditura u konstatua nga ekspertiza financiare e datës 03.06.2024 të punuar nga eksperti financiar Sh.S., sqarimeve të ekspertit si në seancën e datës 04.07.2024 dhe e vërtetuar edhe nga dëshmia e pagesës bankare e datës 21.04.2022.

Prandaj, nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, komfor nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Nisur nga kjo, Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b, të KDAK-së Nr.03/L-109, nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e anuloi aktvendimin e kontestuar, duke obliguar të paditurën që paditësit t’ia kthej shumën prej 3,783.95, të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-21688/11.05.2011 R-23232/18.05.2011, R-23339/19.05.2011, R-27108/07.06.2011 dhe R-33136/07.07.2011, të proceduar në ZBD Hani i Elezit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Gjykata i ka vlerësuar deklarinimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.491/2022 datë 04.07.2024

Zyrtare Ligjore
Amire JAHIRI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.